



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

Nr. 4904/Prot
1

Tiranë, më 03 / 08 / 2020

URDHËR

Nr. 262, datë 03 . 08 . 2020

**“PËR RREGULLAT DHE PROCEDURAT PËR NJOHJEN E TITULLIT
NDËRMJETËS TË FITUAR NË NJË SHTET TË HUAJ”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, të nenit 5 pika 5 si dhe të nenit 6/1-a, shkronja “ç” të ligjit nr. 10385, datë 24.02.2011 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ministri i Drejtësisë i njeh shtetasit të huaj, titullin ndërmjetës të fituar në një shtet të huaj, nëse plotëson kushtet për t’u licencuar si ndërmjetës, sipas parashikimeve të ligjit për ndërmjetësimin dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në këtë Urdhër.
2. Kërkesa për njohjen e titullit ndërmjetës të fituar në shtetin e huaj bashkë me dokumentacionin shoqërues paraqitet pranë Ministrisë së Drejtësisë. Dokumentacioni i lëshuar nga autoriteti përkatës në vendin e huaj paraqitet i legalizuar/apostiluar dhe i përkthyer në gjuhën shqipe sipas legjislacionit në fuqi. Dokumentacioni shoqërues përbëhet nga:
 - a. 2 fotografi;
 - b. Kopje të dokumentit të identifikimit;
 - c. Jetëshkrimi;
 - ç. Kopje të lejes, licencës ose aktit të lëshuar nga autoriteti përkatës, i cili sipas legjislacionit në shtetin e origjinës, i njeh të drejtën e ushtrimit të veprimtarisë së ndërmjetësimit;
 - d. Kopje të diplomës ose dokumentacionit që vërteton përfundimin e studimeve të larta;

- dh. Vërtetim sipas legjislacionit në shtetin e origjinës se shtetasi nuk është dënuar për kryerjen e veprave penale;
 - e. Dokumentacionin që vërteton ndjekjen e një programi trajnimi që lidhet me ndërmjetësimin;
 - ë. Vërtetim i lëshuar nga autoriteti licencues apo rregullator në shtetin e origjinës se ndërmjetësi është anëtar/regjistruar pranë këtij autoriteti dhe se ushtron në mënyrë aktive profesionin e ndërmjetësit.
3. Kërkesa për njohjen e titullit ndërmjetës të fituar në shtetin e huaj shqyrtohet brenda 45 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës.
 4. Gjatë shqyrtimit të kërkesës për njohje, struktura përgjegjëse në Drejtorinë e Përgjithshme e Rregullatore të Çështjeve të Drejtësisë, ka të drejtë të kërkojë nga shtetasi i huaj informacion ose plotësim dokumentacioni në rast se dokumentacioni nuk paraqitet në përputhje me parashikimet e këtij urdhri, si dhe verifikim të të dhënave nga institucionet vendase dhe të huaja. Afati për plotësimin e dokumentacionit dhe/ose verifikimin e të dhënave është jo më shumë se 30 ditë.
 5. Mosparaqitja e dokumentacionit ose informacionit e kërkuar, nga ana e shtetasit të huaj brenda afatit 30 ditor, përbën shkak për mospranimin e kërkesës. Në rast se institucionet vendase dhe/ose të huaja, nuk paraqesin informacionin mbi të dhënat për të cilat është kërkuar verifikimi brenda afatit 30 ditor, struktura përgjegjëse në Drejtorinë e Përgjithshme e Rregullatore të Çështjeve të Drejtësisë merr në konsideratë mungesën e përgjigjes ndaj kërkesës për informacion për qëllimet e të provuarit, në përputhje me rrethanat e çështjes. Në ato raste kur informacioni apo dokumentet e kërkuara janë të domosdoshme për shqyrtimin e kërkesës, struktura përgjegjëse në Drejtorinë e Përgjithshme e Rregullatore të Çështjeve të Drejtësisë i propozon Ministrin pezullimin e procedurës dhe njoftimin e kërkuar për këtë fakt.
 6. Struktura përgjegjëse pas shqyrtimit të kërkesës harton një relacion shpjegues në të cilin pasqyrohen të dhënat e dokumentacionit të paraqitur si dhe arsyet mbi propozimin për pranimin ose refuzimin e kërkesës për njohjen e titullit ndërmjetës të fituar në shtetin e origjinës. Relacioni bashkë me urdhrin përkatës, i paraqiten për miratim Ministrin të Drejtësisë i cili më pas vendos për njohjen ose jo të titullit ndërmjetës të fituar në shtetin e huaj.
 7. Në rast pranimi të kërkesës për njohjen e titullit ndërmjetës të fituar në shtetin e huaj, struktura përgjegjëse në Drejtorinë e Përgjithshme e Rregullatore të Çështjeve të Drejtësisë kryen regjistrimin e ndërmjetësit në Regjistrin e Ndërmjetësve si dhe plotëson dosjen personale me dokumentacion, sipas rregullave të përcaktuara në Urdhrin e Ministrin të Drejtësisë “Për formën, përmbajtjen dhe rregullat e administrimit të regjistrin të ndërmjetësve dhe dosjes personale të ndërmjetësit”.
 8. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

9. Ngarkohet Sektori i Arkiv Protokollit për marrjen e masave për njoftimin e këtij urdhri.

10. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren Zyrtare”.

MINISTRI

ETILDA GJONAJ (SALIU)

